

A stylized world map in a light blue color, centered on the Atlantic Ocean, serving as a background for the text.

**UNIVERSITETI I AAB**

**FINANCA NDËRKOMBËTARE**

Prof. Ass. Dr. Bekim Berisha

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

**Pariteti i fuqisë blerëse dhe ligji i një çmimi**

*Ligji i një çmimi në një ekonomi të mbyllur*

- *Ekonomia në të cilën shitblerja e mallrave e shërbimeve realizohet brenda vendit dhe nuk ka transaksione me jasht quhet Ekonomi e mbyllur.*
- *Ligji i një çmimi nënkupton “në qoftë se dy mallra janë identike, ato duhet të shiten me të njejtin çmim”*

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

## Çka është arbitrazhi?

- *Procesi i blerjes dhe i shitjes së diçkaje me qëllim që të përfitohet një diferencë çmimi duke siguruar një fitim kundrejt një risku të ulët.*

## Çka janë shpenzimet e transaksionit?

*Gjatë arbitrazhit mirren mbi vehte shenzime të ndryshme informacioni mbi tregjet, transportit të mallit, të kalimit nga një palë te tjetra, etj.*

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

**Cilat transaksione realizohen në një spekulim?**

## **Shembull:**

Bleu 100 bileta me 450 EUR = 45,000 EUR

Kostoja e transaksionit = 100 EUR

Kostoja totale = 45,100 EUR

## **Të ardhurat**

Shet 100 bileta me 500 EUR = 50,000 EUR

Fitimi (50,000 – 45,100) = 4,900 EUR

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

**Ligji i një çmimi në një ekonomi të hapur**

**Ekonomi e hapur nënkupton:**

*Shkëmbimin e mallrave e shërbimeve mes vendeve të ndryshme.*

*Supozojmë se biletat shiten në dy qytete të dy vendeve të ndryshme (Tirana – Roma) A-I*

*Një agjenci në Romë e shpreh vlerën 500 lekë në EUR sepse monedhat i kanë të ndryshme.*

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

**Rregulla themelore:**

*Kur blihet një mall / një vendi tjetër, së pari duhet të ndryshohet paraja e brendshme në para të huaj dhe pastaj të këmbehet monedha e huaj me mallin përkatës. Këtu kemi të bëjmë me një raport këmbimi ndërmjet monedhave të dy vendeve përkatëse.*

**Kursi i këmbimit** – është çmimi / një njësie të monedhës së huaj e matur me njësitë e monedhës së brendshme

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

Shqiptari e kupton kursin e këmbimit me EUR si raport:

$$136 \text{ ALL} = 1 \text{ EUR}$$

Italiani e kupton:

$$0.0073 \text{ EUR} = 1 \text{ ALL}$$

**N**ëse çmimi i biletave do të jetë 100 EUR, atëherë shuma e tyre në lekë do të jetë:

$$136 \times 100 = 13,600 \text{ ALL}$$

*(çmimi në ALL i 1 EUR) x (çmimi në EUR i biletës) = çmimi në ALL i biletave*

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

## Konceptet bazë për kurset e këmbimit

*Kursi i këmbimit valutor është:*

- *Raporti i këmbimit ndërmjet dy monedhave*
- *Çmimi në njësi të monedhës kombëtare i një njësie të një monedhe të një vendi tjetër*



# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

Çka mirret si bazë për këto raporte?

- *Pariteti në arë, dhe*
- *Pariteti i fuqisë blerëse*

Pariteti në ar i këmbimit – është barazim i monedhave të ndryshme mbi bazën e përmbajtjes së tyre në ar.  
Psh: dy kartëmonedha e kanë përmbajtjen në ar përkatësisht 0,875 dhe 0.125. Kursi i tyre do të jetë 1:7 (875/125) një njësi e monedhës së parë = me 7 njësi tv monedhës së dytë.

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

Pariteti sipas fuqisë blerëse – është barazim i monedhave të ndryshme mbi bazën e fuqisë blerëse që ato kanë në vendet e tyre.

Për ta përcaktuar këtë, merret një vëllim e strukturë e caktuar mallrash dhe shërbimesh (shportë mallrash) shumëzohet me çmimin respektiv të tyre në monedhën e njërit vend dhe pastaj me çmimet përkatëse në monedhën e vendit tjetër.

# KUPTIMI I KURSEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

## Pariteti sipas fuqisë blerëse

*Shembull:*

*Me çmimet në dollar amerikan jep shumën 200 milion dollar dhe me çmimet në paund jep shumën 100 milion. Duke pjestuar përfundimin që marrëm, nxjerrim kursin 2 : 1 (200/100). Pra 2 USD = 1 GBP.*

*Ky quhet kurs i bazuar në paritetin e fuqisë blerëse.*

# Sistemi valutor alternativ i kurseve të këmbimit

- *Kursi i këmbimit është krahas pagës, një nga çmimet më të rëndësishme të ekonomisë nv tërësi.*
- *Është hallkë lidhëse midis ekonomisë së brendshme dhe trgut botëror.*
- *Alternativat e lidhjes së ekonomive vendore me ato botërore janë:*
  1. *Fiksimi I çmimeve të monedhës kundrejt një ose grupi valutash të huaja;*
  2. *Mund të lejojnë luhatjen lirshëm të valutës në tregjet valutore kundrejt valutave të huaja;*
  3. *Ose ta ndjeknin rrugën e ndërmjetme.*

# Sistemi valutor i kurseve të këmbimit fikse

- *Kursi i këmbimit fiks shpallet nga qeveria.*
- *Ekzistojnë dy mënyra për ta mbajtur kursin fiks:*
  1. *E para, është karakteristikë e vendeve në zhvillim, miratohet me ligj i cili e ndalon këmbimin e monedhës vendase me monedhat e huaja me një kurs i përcaktuar ndryshe nga ai i qeverisë.*
  2. *E dyta, qeveria nuk i ndalon subjektet ekonomike private të këmbejnë monedha me të huaja, por e gatshme të thithë teprica për të përmbushur mungesën e monedhës vendase. Qeveria blen ose shet sasisht e tepërta ose të mangëta të monedhës vendase.*

*Përparësitë dhe dobësitë janë për të dyja mënyrat*

# Sistemi i përzier

- *Bashkojnë elemente të kurseve të lira fleksibile me kurse fikse. Ekzistojnë shumë sisteme të përziera:*
  1. *Kurse fikse këmbimi që mund të luhaten brenda kufijve të caktuar me gjerësi të kufizuar, me mundësi të caktuara luhatjeje*
  2. *Kurse fikse këmbimi me aftësi përshtatje ose me përshtatje paritetesh.*
- *Përveç regjimit valutor, elemente tjera që dallojnë sistemet valutore nga një tjetër janë:*
  - A) *Iloji I rezervave valutore, dhe*
  - B) *shkalla e lëvizshmërisv së kapitaleve*

# Kriteret për zgjedhjen e një sistemi valutator

*Janë:*

- 1. Pesha dhe roli I tregtisë së jashtme;*
- 2. Shkalla e diversifikimit të prodhimit*
- 3. Madhësia e ekonomisë*
- 4. Preferenca për stabilitetin e nivelit të çmimeve*